



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 52/2 Prot.

Tiranë, më 22.08. 2025

UDHËZIM

Nr. 21, datë 22.08.2025

**PËR NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR. 26, DATË 25.11.2019 “PËR MËSUESIN
NDIHMËS PËR NXËNËSIT ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË INSTITUCIONET
PUBLIKE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 3, të nenit 65, të ligjit nr. 69, datë 21.06.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe të urdhrit nr. 609, datë 20.12.2024, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, znj. Orjana Osmani”,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 26, datë 25.11.2019 “Për mësuesin ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar”, pas pikës 4, të shtohet pika 4.1 me këtë përmbajtje:

“4.1 Në raste të veçanta, bazuar në vlerësimin e ngarkesës mësimore të mësuesve ndihmës, me miratim të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar, brenda numrit aktual të mësuesve ndihmës, një mësues ndihmës mund të punojë edhe me deri në dy nxënës me aftësi të kufizuara, bazuar në nivelin e vështirësisë dhe nevojës për mbështetje që paraqet nxënësi.”

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTRI

ORJANA OSMANI

